



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 2.2, pika c e Ligjit nr. 03/L- 040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 9 të Ligjit 03/L-49, për financat e pushtetit lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 27/2008), të nenit 9, paragrafi 1 i Ligjit nr. 06/L-005, për tatimin në pronën e paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 2/15, shkurt 2018"), të nenit 39/A të Ligjit nr. 08/L-224, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005, për tatimin në pronën e paluajtshme, të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja c të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 -391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2023, miratoi këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E SHKALLËS TATIMORE TË TATIMIT NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2024

Neni 1 **Qëllimi**

Në bazë të nenit 39/A të Ligjit nr. 08/L-224, për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit nr. 06/L-005, për tatimin në pronën e paluajtshme, caktohen shkallën tatimore për vitin 2024, për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë "pronë publike", si vijon:

- Për njësitë bujqësore të parcelave-----0.10%
- Për njësitë bujqësore të objekteve-----0.10%
- Për njësitë pyjore të parcelave-----0.15%
- Për njësitë rezidenciale të parcelave-----0.10%
- Për njësitë rezidenciale të objekteve----- 0.15%
- Për njësitë komerciale të parcelave-----0.10%
- Për njësitë komerciale të objekteve-----0.15%
- Për njësitë industriale të parcelave-----0.15%
- Për njësitë industriale të objekteve-----0.17%

Neni 2
Aktet e vendimit

Pjese përbërëse e këtij vendimi janë: Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për Komunën e Prishtinës, 09. nr. 2449/2022, dt. 31.10.2022, Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për prona komerciale, 09/463 nr. 953/2023, dt. 31.10.2023, Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për prona komerciale dhe industriale për Komunën e Prishtinës, 09. nr. 432, dt. 30.10.2020 (Raport i cili vlen vetëm për kategorinë e pronës industriale) dhe Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për Komunën e Prishtinës, 09. nr. 2045-1, dt. 31.10.2018, të nxjerra nga Ministria e Financave.

Neni 3
Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Financave, përkatësisht Sektori i tatimit në pronë.

Neni 4
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi për caktimin e normave të tatimit në pronën e paluajtshme, për vitin 2021, me nr. 01-431/03- 4399/21, dt. 11.01.2021.

Neni 5
Hyrja ne fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-011/01-227565/23, më 01.12.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajçinovci



ARSYETIM

Në zbatim të nenit 39/A të Ligjit nr. 08/L-224, propozojmë që vendosjen e shkallëve tatimore për kategoritë e pronave rezidenciale, komerciale, industriale dhe bujqësore, dhe për njësitë e parcelave rezidenciale, komerciale, industriale dhe bujqësore, si më lart.

Vlerësimet e pronave të paluajtshme për njësitë rezidenciale të objekteve, që përfshinë kategorinë e vlerës për apartament, shtëpi familjare, garazh për shfrytëzim privat dhe objekt tjetër rezidencial, si dhe të tokës rezidenciale, që përfshinë kategorinë e vlerës për parcelë për shtëpi familjare, apartamente dhe parcelë për objekt tjetër rezidencial, janë caktuar sipas Raportit mbi vlerësimin e përgjithshëm për Komunën e Prishtinës, 09. nr. 2449/2022, dt. 31.10.2022.

Vlerësimet e pronave të paluajtshme për njësitë, parcelë komerciale të tokës komerciale, që përfshinë kategorinë e vlerës për parcelë për objekt komerciale, parcelë për rekreacion komercial dhe parcelë për transport komercial, si dhe njësitë e objekteve komerciale që përfshinë: kategorinë e vlerës për shitore, zyrë, restorant, hotel, objekt për magazinim komercial, garazh komercial, pishinë për shfrytëzim komercial, fushë e hapur sportive, fushë e mbyllur sportive, pompë benzine dhe objekt tjetër komercial, janë caktuar sipas Raportit mbi vlerësimin e përgjithshëm për prona komerciale, 09/463. nr. 935/2023, datë 31.10.2023.

Në këtë raport nuk është përfshirë vlerësimi i pronës industriale, dhe të njëjtat vlera mbeten sipas "Raportit mbi vlerësimin e përgjithshëm për prona komerciale dhe industriale për Komunën e Prishtinës, 09 nr. 432, datë 30.10.2020". Ky Raport vlen vetëm për kategorinë e pronës industriale, tipi i njësisë - parcelë industriale dhe objekt industrial.

Po ashtu, vlerësimi i pronave bujqësore mbetet sipas vlerësimit me Raportin mbi vlerësimin e përgjithshëm për Komunën e Prishtinës, 09 nr. 2045-1, datë 31.10.2018.

Në përputhje me Kapitullin V, nenin 17 të Ligjit nr. 06/L-005, raportet e vlerësimeve janë të nxjerra nga Ministria e Financave, si autoritet kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit.

Për njësitë rezidenciale të objekteve propozohet të mbetet sikurse për vitin tatimor 2023, me shkallë 0.15%, me arsyetim se, në vlerën e vlerësuar kanë ndikuar indikatorët, që është kualiteti i ndërtimit, sipas Vendimit nr.149/2023, datë 06.10.2023, të nxjerrë nga DTP-ja, si dhe nenit 3 të Ligjit nr. 08/L-224, i lejohet zbritja prej tridhjetë mijë (30,000) euro nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, e që deri në vitin 2023 ka qenë pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro.

Për njësitë komerciale të objekteve propozohet të caktohet shkalla tatimore 0.15% me arsyetimin se, kemi ngritje mesatare të vlerave të vlerësuara të objekteve komerciale, për afërsisht 60% në tërë territorin e Prishtinës, bazuar në raportin e dt. 31.10.2023.

Për njësitë e parcelave rezidenciale dhe komerciale, propozohet shkalla tatimore më e ulët 0.10%, me arsyetim se kemi ngritjet të vlerës së pronave – tokës rezidenciale dhe komerciale sipas raporteve të cekura si më lart.

Për njësitë e kategorisë së pronës bujqësore, propozohet shkalla tatimore 0.10%, për shkak se në vitin 2024 do të tatonen edhe pronat bujqësore, e të cilat kanë qenë të liruara nga tatimi në pronë deri në vitin 2023, sipas ligjit bazik në fuqi.

Për njësitë e kategorisë së pronës pyjore, propozohet të mbetet njësoj sikurse në vitin paraprak, 0.15%, për shkak se nuk kemi vlerësim të pronave të paluajtshme dhe mbetet vlerësimi me raportin e datës 31.10.2018.

Për njësitë e parcelave industriale dhe njësitë e objekteve industriale, propozohet të mbetet njësoj sikurse në vitin paraprak, 0.15% dhe 0.17%, për shkak se nuk kemi vlerësim të pronave të paluajtshme me raportin e datës 31.10.2023, andaj dhe vetëm pjesa e raportit për kategorinë e pronës industriale mbetet pjesë përbërëse e Vendimit mbi caktimin e shkallës për tatimin në pronë e paluajtshme për vitin 2024.

Kjo drejtori, respektivisht Sektori i tatimit në prunë, propozon që në seancën e radhës të Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2024, për tatim në pronë të miratohen shkallët tatimore të cekura si më lart.